



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 997/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) paraqitur kundër votuesit Skender Rama për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor ne raundin e dyte te zgjedhjeve lokale , në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetevendosje (LVV) dega ne Prishtine .

Arsyetim

PZAP-i, më datë 02.12.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Levizja Vetevendosje (LVV), në të cilën theksohet se me datën 01.Dhjetor 2013, ne ora 11:35 ne shkollën fillore “Nazim Gafurri” ne vendvotimin nr1920X/04 personi me emrin Skender Rama me numer te leternjoftimit 1231092877 ka bere fotografimin e votes.Duke qene se ne kodin penal te Republikes se Kosoves ne nenin 210 “Cenimi i fshehtesise se Votimit” par .1.fotografimi i votes konsiderohet veper penale, kerkojme nga PZAP-i qe ne baze te pretendimeve te parashtruara ne kete ankesa dhe deshmise se dhene, te mere vendim ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.Kjo shkelje eshte raportuar nga veshguesi i LVV-se Taulant Krasniqi me nr te telefonit 044-414-678 gjithashtu si deshmitare mund te konsiderohet edhe Blerina Krasniqi me nr tel 044-154-027 veshguese nga Demokracia ne Veprim. Kesaj ankesa do ti bashklidhet deshmia ne forme te shkruar e deklaruar nga veshguesi i LVV-së

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmite e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se eshte penguar procesi Zgjedhor , PZAP-i i vlerëson si pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së,si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 997/2013 më datën 04.12.2013



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*